

KOHA DITORE

07.05.2011.

## Komuna e Kaçanikut përfiton nga projekti LOGOS Qeveria zvicerane financon urën e re që lidh dy pjesët e Kaçanikut

Projekti LOGOS i Qeverisë zvicerane i ka alokuar 50 mijë euro për ndërtimin e urës së re mbi lumin Neredime në Kaçanik

KOHA  
Ditore

### EKREM RAKA

KAÇANIK, 6 MAJ - Qeveria zvicerane "do ta pensionoje" urën "antike" që vazhdon t'i lidhë dy pjesët e qytetit Kaçanik që nga vitet '30 të shekullit të kaluar. "Projekti LOGOS i Qeverisë zvicerane i ka alokuar 50 mijë euro për ndërtimin e urës së re mbi lumin Neredime në Kaçanik", ka bërë të ditur Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës së Kaçanikut, të premten. Ndërkao, Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, ka nën vizuar se projekti do të kushtojë më shumë se mjetet e alokuara. "Mjetet që do të mungojnë do të sigurohen nga buxheti komunal", ka theksuar ai. Zyrtarë të tjerë komunalë kanë thënë se tenderi për ndërtimin e urës së re mbi Neredime do të shpallet shumë shpejt. "Eshtë çështje ditësh shpalla e tenderit, ndërsa nuk e përjashtoj mundësinë që kjo të ndodhë javën e ardhshme", ka thënë Zeqir

Selmani, menaxher i Zyrës së prokurimit. Eshtë thënë se shpalljen e shpejtë të tenderit e mundëson ekzistimi i planit të detajur të urës së re. "Ky plan eshtë punuar nga një kompani e licencuar për hartim projektesh", ka thënë Fatos Koxha, zyrtar i Urbanizmit. Sipas tij, ura e re do të ndërtohet përskaj ekzistueses. "Ura e re do të jetë me dimensione standarde për lëvizje të papenguar automjetesh në të dyja drejtimet, ndërsa do të ketë edhe shtigje për këmbësorë", ka nën vizuar ai. Deri në përirimin e urës së re, dy pjesët e qytetit Kaçanik do të vazhdojnë t'i lidhë ura "antike", konstruktit metalik, e montuar aty nga autoritetet e ish-Mbretërisë së Jugosllavisë në vitet '30 të shekullit të kaluar. Gjerësia e kësaj ure eshtë e pamjaftueshme për qarkullim mbi të të një kamioni dhe një viture gjatë lëvizjes me kah të kundërt.